

Eqrem Çabej

Kundër pseudofilologëve

Nga shtyllat e Shekullit të Ri të verës, si dhe nga ato të Gazetës së Re duket çiltas se një epidemi grafomanie paska kapur shumë “Krena të nalta”! Kush në jetën e tija ka pasur raste të mësojë anglishten nëpër fabrikat e Amerikës, gjermanishten në tabari-et e Vjenës, frëngjishten në Mont-Martre, e italishten në Kafet’ e Barit, sot, i fryrë si gjeldeti, na del përpara, i stolitur me rrobën transparente të pseudonimit, e...-o tempora, o mores! – me gjest dramatik na flet mbi filologji! *Avanti pra! Parturiunt montes, nascetur ridiculus mus!**

Pra sikundër në fletoret e Perëndimit ndodhet feuilleton-i, tek ne nuk do të mungojë, si frukt pas buke, një artikull “filologjik”, i cili ka misionin, si ç’duket, të zëvendësojë një zakon shqiptar që është duke u shuar: luftën e gjelave.

Nënë maskën e shkabës, këta gjela luftojnë trimërisht me njërijetrin, duke u gjakësuar, por dhe me maskë që jeni, e dimë se jeni gjela, o gjela!

Tash, duke lënë të qeshurit, duhet të konstatojmë me hidhërim se është një turp kulturor për ne, që Atdheu i ynë është ay vend i Europës, në të cilin në shekullin e XX, njerëz që mundet të jenë të zotë për nëpunësira ndofta dhe të nalta, por që s’dinë as pikë prej filologjisë, njerëz që në jetën e tyre s’kanë dëgjuar një Konferencë filologjike, njerëz që s’kanë as më të vogëlën ide mbi mënyrën si punohet sot në lëmin e gjuhës, që të tillë njerës dalin e mbushin shtyllat e fletoreve me

Eqrem Çabej

Contro gli pseudofilologi

Dalle colonne del “Shekulli i Ri” estivo, così come da quelle della “Gazeta e Re”, si nota chiaramente che una epidemia di grafomania abbia contagiato molti “Personaggi dei vertici”! Chi nella sua vita ha avuto l’occasione di apprendere l’inglese nelle fabbriche d’America, il tedesco nei tabarin di Vienna, il francese a Mont-Martre, e l’italiano nei Caffè di Bari, oggi pieno di se, pavoneggiandosi, ci si presenta ammantato delle trasparenti vesti dello pseudonimo, e ... - o tempora, o mores! – con modi drammatici ci parla di filologia ! *Avanti allora! Parturiunt montes, nascetur ridiculus mus!**

Quindi come nei giornali dell’Occidente abbiamo il feuilleton, da noi non manca, come la frutta al termine del pasto, un articolo “filologico”, il quale ha come missione, a quanto sembra, di sostituire una tradizione albanese che va scomparendo: il combattimento dei galli.

Sotto la maschera dell’aquila, questi galli si combattono coraggiosamente l’un l’altro, insanguinandosi, ma nonostante la maschera, noi sappiamo che siete galli, o galli!

Ora, scherzi a parte, dobbiamo constatare con amarezza che per noi è una vergogna culturale, che la nostra Patria è quel paese d’Europa, dove nel XX secolo, persone che potrebbero essere capaci di assumersi responsabilità anche di alto livello, ma che non conoscono neanche un po’ di filologia, persone che nella loro vita non hanno mai ascoltato una Conferenza di filologia, persone che non hanno la

artikuj jo vetëm fare të kotë, por edhe të dëmshëm e duke u sharë me shoqishoin, dhe si! Kush i përflet tjetrit se tash doli nga veja, dhe sikur ay ishte nër “shpërgajt” e djepit, ky punonte për Shqipëri!

Bukur! Patriota! Por kush ju tha të futeni në labirintet e gjuhës? E me ç’të drejtë e quan tjetrin “ignorant” vetëm pse është kundërshtar i “ideve filologjike” të tua?

A është kjo filologji? A imponohet njeriu me sharje?

Zakoni i botës së qytetëruar e do që të luftohet për ide, e jo për inate personale, për ç’fryrjen e të cilavet janë të çelura kaq gjykatore!

Sot secili në Europën e qytetëruar; para se të merret me shkrime filologjike, i shkon mjaft viet në bankat e universitetit, atje ku gjuha studiohet e analizohet me exaktitudë matematike, duke qenë se filologjia është një nga dituritë më të shtërngueshme (severe) e më exakte që munt të jenë në botë.

Se të mos ishte kështu, nuk rrinte Gustav Meyer-i të merresh tridhet viet me radhë me albanologji d.m.th. me studimin e asaj gjuhe të shkretë, të cilën “filologët” t’anë të sodit, të dalë shpejt si kërpullat pas një shiu, janë duke e përçmuar në një mënyrë të tillë!

Kurrkush nuk ka të drejtë të shkruajë mbi gjuhë pa u pat marrë viet me rradhë me studimin e vërtetë të saj! Kurrkush! Se gjuha është sendi më i çmueshëm i një populli, dhe për popullin shqiptar është i vetmi thesar! Dhe mos e ngani thesarin me duart t’uaja, zotërinj dilettanta!

minima idea su come si lavora oggi nel campo della lingua, persone simili che vengono fuori e riempiono le colonne dei giornali con articoli non solo inutili, ma anche dannosi insultandosi l’un l’altro, e come si insultano! Chi dice all’altro di essere appena uscito dall’uovo e che quando si trovava nella culla, questo lavorava già per l’Albania! Bene, oh Patrioti! Ma chi vi ha detto di addentrarvi nei labirinti della lingua? E con quale diritto chiamate l’altro “ignorante”, solo perché si contrappone alle vostre “idee filologiche”?

È questa la filologia? L’uomo forse si afferma insultando l’altro?

È tradizione del mondo civile che si combatta per le idee, e non per rancori personali, per sbollire i quali sono aperti tanti tribunali!

Oggi ognuno nell’Europa civile, prima di occuparsi di scritti filologici, passa un bel po’ di anni sui banchi dell’università, lì dove la lingua si studia e si analizza con esattezza matematica, essendo la filologia una dei saperi più severi e più esatti che possa esistere al mondo.

Se non fosse così, Gustav Meyer non si sarebbe occupato per trent’anni di seguito di albanologia e cioè dello studio di quella povera lingua, che ora i nostri odierni “filologi”, venuti fuori velocemente come i funghi dopo la pioggia, stanno svilendo in questo modo!

Nessuno ha il diritto di scrivere sulla lingua senza avervi prima dedicato anni ed anni di studi severi! Nessuno! Poiché la lingua è l’oggetto più prezioso di un popolo, e per il popolo albanese è l’unico tesoro! E non azzardatevi a toccare questo tesoro con le vostre mani, signori dilettanti!

Gjuha është një element i naltë kulture, nuk është një objekt mode! Nuk mundet të riformohet aq shpejtas si ç'mundesh secili të vishet a la Perrot për Karnaval.

Kush ju ka shtyrë ju të shkruani mbi gjuhë? Kur keni manin'e shkrimit, pse nuk shkruani ç'të doni mbi numismatikë, grafologji, matematikë, teologji, përmbi fizikë, anatomi, analytikë e histori? E t'a lini rehat këtë gjuhë të shkretë, e t'a punojnë të tjerë të cilët të merren me të vërtetë me studimin e saj?

Kush do të shkruaj mbi shqipen, më parë duhet të jetë marrë me studimin e gjuhëveve indoevropiane përgjithësisht, e pastaj duhet të ketë studiuar gjithë shkrimtarët shqiptarë e gjithë albanologët e huaj, numri i të cilëveve është aq i math, sa studimi i tyre lyp viet me radhë pune të parreshtur.

Se filologjia nuk është zbavitje, është larg nga diletantismi. Është dituri, dhe që të kapesh me dituri, duhet të dish!

Graz, Austri, 08.02.1929

*I ribotuar në "BOTA SHQIPTARE",
Romë 2008, nr. 189, f.13*

La lingua è un elemento elevato della cultura, non un oggetto soggetto alle mode! Non si può riformare così velocemente come ci si può vestire alla Pierrot a Carnevale.

Chi vi ha spinti a scrivere sulla lingua? Quando vi viene la mania di scrivere, perché non scrivete quello che volete sulla numismatica, la grafologia, la matematica, la teologia, la fisica, l'anatomia, l'analitica e la storia? E lasciate così in pace questa povera lingua, e fate in modo che di essa si occupino altri che sono seriamente interessati al suo studio?

Chi vuole scrivere sull'albanese, prima di tutto si deve essere già occupato dello studio delle lingue indoeuropee in genere, e in seguito deve avere studiato tutti gli scrittori albanesi e tutti gli albanologi stranieri, il numero dei quali è così alto che il loro studio richiede anni di continuo lavoro.

La filologia non è divertimento, essa è lontana dal diletantismo. È sapere, e per occupartene con nozione di causa, devi sapere.

Graz, Austria, 08.02.1929

Ripubblicato in "BOTA SHQIPTARE",
Roma 2008, nr.189, p. 13

■ I SHKRUAR DJE

EQEREM ÇABEJ

Kundër pseudofilologëve



Nga shtyllat e Shekullit të Ri të verës, si dhe nga ato të Gazetës së Re duket çiltas se një epidemi grafomanie paska kapur shumë "Krena të naltë"! Kush në jetën e tija ka pasur raste të mësojë anglishten nëpër fabrikat e Amerikës, gjermanishten në tabari-et e Vjenës, frëngjishten në Mont-Martre, e italishten në Kafet' e Barit, sot, i fryrë si gjeldejti, na del përpara, i stolitur me rrobën transparente të pseudonimit, e...-o tempora, o mores! - me gjest dramatik na flet mbi filologji! Avanti pra! Parturiunt montes, nascetur ridiculus mus!*

Pra, sikundër në fletoret e Perëndimit ndodhet feuilleton-i, tek ne nuk do të mungojë, si frukt pas buke, një artikull "filologjik", i cili ka misionin, si ç'duket, të zëvendësojë një zakon shqiptar që

është duke u shuar: luftën e gjelave. Nënë maskën e shkabës, këta gjela luftojnë trimërisht me njerijet, duke u gjakësuar; por dhe me maskë që jeni, e dimë se jeni gjela, o gjela!

Tash, duke lënë të qeshurit, duhet të konstatojmë me hidhërim se është një turp kulturor për ne, që Atdheu i ynë është ay vend i Europës, në të cilin në shekullin e XX, njerëz që mundet të jenë të zotë për nëpunësira ndofta dhe të nahta, por që s'dinë as pikë prej filologjisë, njerëz që në jetën e tyre s'kanë dëgjuar një Konferencë filologjike, njerëz që s'kanë as më të vogëlën ide mbi mënyrën si punohet sot në lëmin e gjuhës, që të tillë njerës dalin e mbushin shtyllat e fletoreve me artikuj jo vetëm fare të kotë, por edhe të dëmshëm e duke u sharë me shoqishorin, dhe si! Kush i përjet tjetrit se tash doli nga veja, dhe se kur ay ishte nër "shpërgajt" e djepit, ky punonte për Shqipëri! Bukur! Patriota! Por kush ju tha të futeni nër labirintet e gjuhës? E me ç'të drejtë e quan tjetrin "ignorant" vetëm pse është kundërshtar i "ideve filologjike" të tua?

A është kjo filologji? A imponohet njeriu me sharje?

Zakoni i botës së qytetëruar e do që të luftohet për ide, e jo për inate personale, për ç'fryrjen e të cilave janë të çelura kaq gjykatore!

Sot secili në Europën e qytetëruar, para se të merret me shkrime filologjike, i shkon mjaft viet në bankat e universitetit, atje ku gjuha studiohet e analizohet me eksaktitudë matematike, duke qenë se filologjia është një nga dituritë më të shtrëngueshme (severe) e më exakte që munt të jenë në botë.

Se të mos ishte kështu, nuk rrinte Gustav Meyer-i të merresh tridhet viet me radhë me albanologji d.m.th. me studimin e asaj gjuhe të shkretë, të cilën "filologët" t'anë të sodit, të dalë shpejt si kërpullat pas një shiu, janë duke e përcëmuar në një mënyrë të tillë!

Kurrkush nuk ka të drejtë të shkruajë mbi gjuhë pa u pat marrë viet me radhë me studimin e vërtetë të saj! Kurrkush! Se gjuha është sendi më i çmueshëm i një populli, dhe për popullin shqiptar është i vetmi thesar! Dhe mos e ngani thesarin me duart t'uaja, zotërinj dilettanta!

Gjuha është një element i naltë kulture, nuk është një objekt mode! Nuk mundet të "rifirmohet" aq shpejtas si ç'mundesh secili të vishet a la Perrot për Karnaval!

Kush ju ka shtyrë ju të shkruani mbi gjuhë? Kur keni maninë shkrimit, pse nuk shkruani ç'të doni mbi numismatikë, grafologji, matematikë, teologji, përmbi fizikë, anatomi, analitikë e histori? E t'a lini rehat këtë gjuhë të shkretë, e t'a punojnë të tjerë të cilët të merren me të vërtetë me studimin e saj?

Kush do të shkruaj mbi shqipen, më parë duhet të jetë marrë me studimin e gjuhëveve indoevropiane përgjithësisht, e pastaj duhet të ketë studiuar gjithë shkrimtarët shqiptarë e gjithë albanologët e huaj, numri i të cilëve është aq i math, sa studimi i tyre hyp viet me radhë pune të parreshtuar.

Se filologjia nuk është zbatimje, është larg nga dilettantism. Është dituri, dhe që të kapesht me dituri, duhet të dish!

Graz, Austri, 08.02.1929

* - Latinisht, fjalë për fjalë: "Maleve u kanë ardhur dhimbjet e lindjes, do të pjellin një mi qesharak." Në shqip cilati latin është shndërruar në proverbin "U mbars mali, e polli një mi" (sh. i red.)

Duket i shkruar dje ky duf i një Egerem Çabej 21 vjeçar, të cilit duket se i ka ardhur në majë të hundës teksa sheh nëpër "fletoret" e shtypi shqiptar të kohës epideminë e grafomanisë që ka zënë shqiptarët për t'u shprehur në çështje të gjuhës.

Por gjuha është një çështje tepër e naltë për t'iu lënë diletantëve, është "i vetmi thesar për popullin shqiptar" shkruan Çabej.

Nuk jemi në gjendje të rindërtojmë kontekstin historik mbi të cilin ka lindur debati, por ndërhyrja e ashpër e Çabejt, atij që do të bëhej gjuhëtari më i madh shqiptar, që do ta lëvronte e kultivonte shqipen në nivelet më të larta, me studimet e veta etimologjike, leksiologjike, duke shtruar rrugën për kodifikimin teorik të gjuhës letrare kurorëzuar me Kongresin e Drejtshkrimit të vitit 1972, e bën këtë shkrim të 1929-ës aktual në thirrjen e vet për t'ua lënë çështjen e gjuhës gjuhëtarëve. Pikërisht sot kur një debat shterpë mbi gjuhën letrare ka kohë që ka pllakosur faqet e shtypit shqiptar, me pjesëmarrje të shumtë të po asi gjelash që 80 vjet më parë i kanë ngritur xhindet filologut më të madh shqiptar. Figurë që i mungon sot gjuhësisë shqiptare. (red)

Lart, Egerem Çabej 20 vjeçar gjatë studimeve të tij në Austri më 1928. Çabej do të vdiste në një klinikë të Romës më 1980, në moshën 72 vjeçare



Kurrkush nuk ka të drejtë të shkruajë mbi gjuhë pa u pat marrë viet me radhë me studimin e vërtetë të saj! Kurrkush! Se gjuha është sendi më i çmueshëm i një populli, dhe për popullin shqiptar është i vetmi thesar! Dhe mos e ngani thesarin me duart t'uaja, zotërinj dilettanta!